



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejme "Bordi i FAK") në mbledhjen së vet të datës 26.01.2017 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 01/2017

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË FEDERATËS AERONAUTIKE TË KOSOVËS

Vëmendje: Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje 01/2017, shfuqizohet rregullorja paraprake e punës së bordit të FAK.

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Bordi i FAK është organi më i lartë ekzekutiv i Federatës Aeronautike të Kosovës.
- 1.2 Bordi i FAK përbëhet nga kryetari/kryetarja i/e FAK i/e cili/cila njëkohësisht është edhe kryetar/kryetare i/e bordit, nënkryetarët e FAK, sekretari i FAK, nga anëtarët tjerë të bordit që janë zgjedhur nga kuvendi i FAK, si dhe tre anëtarët të emëruar nga kryetari i FAK.
- 1.3 Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi apo dorëheqja e anëtarëve të bordit të FAK bëhen në pajtim me statutin e FAK dhe aktet tjera normative të FAK.
- 1.4 Për punën dhe funksionimin e vet, bordi i FAK i përgjigjet Kuvendit të FAK.

Neni 2.

Përgjegjësitë e Bordit

- 2.1. Bordi i FAK obligohet që t'i kryejë me përgjegjësi të gjitha obligimet dhe detyrat që rrjedhin nga statuti dhe aktet tjera normative të FAK.
- 2.2. Në pajtim me statutin e FAK, bordi i FAK ushtron përgjegjësitë në vijim:
 - 2.2.1 Merr vendim për organizimin dhe mbajtjen e kuvendit të FAK si dhe propozon rendin e ditës për mbledhjen e kuvendit.
 - 2.2.2 Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e statutit dhe akteve tjera normative të cilat mund të miratohen nga kuvendi i FAK.
 - 2.2.3 Nxjerr rregulloren mbi anëtarësimin e klubeve dhe shoqatave.



Federata Aeronautike e Kosovës

- 2.2.4 Nxjerr rregulloren mbi licencimin e pilotëve.
- 2.2.5 Ekzekuton vendimet dhe konkluzionet e kuvendit të FAK.
- 2.2.6 Nxjerr rregulloren mbi punën e bordit të FAK.
- 2.2.7 Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të FAK.
- 2.2.8 Ekzekuton strategjinë dhe politikën e përgjithshme të FAK.
- 2.2.9 Emëron sekretarin e përgjithshëm të FAK.
- 2.2.10 Emëron anëtarët e komisioneve të ndryshme të FAK.
- 2.2.11 Vendosë mbi blerjen dhe shitjen e pasurisë së federatës.
- 2.2.12 Miraton listat e zyrtarëve (gjqytarëve, stafit organizativ, asistentëve etj) të garave.
- 2.2.13 Nxjerr rregulloret e brendshme të cilat nuk janë në kompetencë ose obligim i kuvendit të FAK.
- 2.2.14 Miraton kalendarin e garave.
- 2.2.15 Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e federatës.
- 2.2.16 Cakton shumën e pagesës së anëtarësisë vjetore për klubet dhe shoqeatat anëtare të federatës.
- 2.2.17 Cakton shumën për pjesëmarrje në garë (kuotizimi), për të gjitha garat nën ombrellën e federatës.
- 2.2.18 Vendos për pranimin e punëtorëve dhe/ose bashkëpunëtorëve ose edhe kontraktorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në FAK, si dhe shumat për kompenzimin e tyre.
- 2.2.19 Shqyrëton kërkesat e reja për anëtarësim në FAK.
- 2.2.20 Në baza vjetore shqyrëton nëse anëtarët e saj aktiv janë duke i përmbushur kriteret minimale për të mbajtur statusin e anëtarit aktiv.
- 2.2.21 Emëron anëtarët e komisionit dicitlinor të FAK.

3. Bordi i FAK mund të vendosë edhe për çështjet e tjera për të cilat e autorizon Kuvendi, ose të cilat janë të parapara në statutin e FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 3.

Delegimi i kompetencave dhe punëve të bordit

3.1. Bordi i FAK mund të krijoj grupe punuese, komisione *ad hoc*, në rast se ato konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e bordit. Në raste të tilla, bordi përcakton detyrat, kohëgjatësinë/afatet, kompetencat dhe fushëveprimin e komisioneve ose grupeve punuese. Puna në trupa të tilla zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

3.2. Bordi i FAK mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre edhe një personi të vetëm.

3.3. Bordi i FAK mund t'i autorizojë punonjësit administrativ apo profesional të FAK që të kryejnë ndonjë punë që është nën kompetencën e bordit të FAK.

Neni 4.

Sekretari i bordit

4.1. Sekretari i FAK shërben edhe si sekretar i bordit të FAK dhe merr pjesë në të gjitha takimet e tij.

4.2. Sekretari i bordit të FAK është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e bordit, për mbarëvajtjen e korrespondencës elektronike mes bordit dhe anëtarëve dhe komisioneve të veta, dhe për dërgimin e ftesave dhe rendit të ditës tek anëtarët e bordit.

4.3. Sekretari i bordit të FAK është përgjegjës për formulimin e vendimeve të miratuara në bord dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së bordit të FAK.

4.4. Sekretari i bordit të FAK është përgjegjës për mbajtjen e arkivit të bordit të FAK.

Neni 5.

Rrjedha e punës në bord

5.1. Anëtarët e bordit të FAK për mbledhjet e bordit njoftohen përmes ftesave elektronike ose edhe SMS-ve, të cilat dërgohen së paku dy ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e bordit të FAK duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.

Mospjesëmarrja pa ndonjë arsytim radhazi në tre mbledhje të bordit të FAK gjatë një viti kalendarik e sanksionon anëtarin duke e shkarkuar automatikisht nga bordi.



Federata Aeronautike e Kosovës

5.2. Rendi i ditës për mbledhjen e bordit të FAK duhet t'i dërgohet të gjithë anëtarëve së bashku me ftesën për mbledhje.

5.3. Të gjithë anëtarët e bordit të FAK kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen e ftuar. Kjo kërkesë mund t'i parashtrohet me shkrim kryetarit apo sekretarit të bordit në formë elektronike, ose mund të parashtrohet edhe gjatë mbledhjes së bordit, ku në këtë rast bordi vendosë për përfshirje ose jo të pikës së propozuar në rend të ditës.

5.4. Mbledhjet e bordit të FAK i kryeson kryetari i tij. Në mungesë të kryetarit, me autorizim paraprak, mbledhjet e bordit mund të kryesohen nga nënkryetarët e FAK, sekretari i FAK, apo ndonjë anëtar tjetër i bordit.

5.5. Në mbledhjet e bordit të FAK, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtarë ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së bordit të FAK.

5.6. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes të paragrafit 5.5 të këtij neni, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia merr fjalën anëtarit.

5.7. Procesverbali i mbledhjes i mbajtur nga sekretari i bordit, apo në mungesë të tij/saj nga ndonjëri prej anëtarëve të bordit duhet t'i përmbajë të gjitha vendimet e nxjerra nga bordi si dhe të gjitha diskutimet relevante në favor apo kundër vendimeve përkatëse.

5.8. Procesverbali i mbledhjes së bordit duhet t'ju dërgohet të gjithë anëtarëve të bordit në formë elektronike jo më vonë se 48 orë nga koha e mbajtjes së mbledhjes së bordit.

5.9. Të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhjen për të cilin është dërguar procesverbali mund ta aprovojnë ose kërkojnë ndryshime në procesverbal me deklaram elektronik brenda 48 orëve nga koha e pranimit të procesverbalit. Në rast se nuk ka refuzime ose kërkesa për ndonjë ndryshim brenda afatit kohor, procesverbali i mbledhjes konsiderohet i miratuar nga bordi i FAK pas 48 orëve nga koha e distribuimit elektronik.

Neni 6.

Votimi dhe vendimet e bordit

6.1. Vendimet e bordit të FAK mund të merren me shumicë të thjeshtë votash në njërin nga dy mënyrat në vijim:



Federata Aeronautike e Kosovës

6.1.1 Në mbledhje të bordit të FAK, në të cilën ka kuorum, pra të pranishëm janë së paku shumica e anëtarëve të bordit (50% plus një anëtarë). Vendimet e bordit të FAK në këtë rast do të jenë të vlefshme në rast se për ato votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve të bordit të FAK të pranishëm në mbledhjen në fjalë.

Në rastet kur në votim në mbledhje, numri i votave “për” dhe “kundër” ndonjë propozimi është i barabartë, vota e kryesuesit të mbledhjes është vendimatarja për propozimin.

6.1.2 Përmes deklaramit/votimit elektronik të anëtarëve të bordit të FAK, me ç’rast vendimet janë të vlefshme vetëm në rast se për miratimin e tyre deklarohen shumica e të gjithë anëtarëve të bordit të FAK brenda afatit kohor prej 48 orëve nga koha e dërgimit të propozimit nga ana e kryetarit të bordit ose sekretarit të bordit. Në rast të mos deklaramit/votimit fare të ndonjë anëtarit të bordit brenda afatit kohor prej 48 orëve, deklarami/vota e anëtarit konsiderohet “për” propozimin e dërguar.

Në rastet kur në votim me deklaram elektronik, numri i votave “për” dhe “kundër” ndonjë propozimi është i barabartë, vota e kryetarit të bordit është vendimatarja për propozimin.

6.2. Të gjitha vendimet e nxjerra nga bordi i FAK duhet të nënshkruhen nga kryetari i bordit të FAK dhe si të tilla duhet të publikohen në webfaqen zyrtare të FAK në afat sa ma të shkurtër kohor.

6.3. Në rastet kur kërkohet ndryshimi ose eventualisht anulimi i ndonjë vendimi të nxjerrë nga bordi i FAK, atëhere duhet të vepohet në mënyrë plotësisht identike dhe me kritere të njejta si për nxjerrjen e vendimit (paragrafi 6.1, nënparagrafët 6.1.1 dhe 6.1.2).

Neni 7.

Hyrja në fuqi

7.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyrë dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, dd.mm.yyyy

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK